Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

02-060/01-0055100-4/26
24.09.2026

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0055100-4/26 dt. 24.09.2026
Mitrovicë

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, nënparagrafi d, nenin 24 dhe nenin 40, paragrafi 2, nënparagrafi b, të Ligjit Nr. 03/L–040 Për vetëqeverisje lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); nenin 61, të Ligjit Nr. 03/L-048 Për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë; Qarkoret Buxhetore 2027/01 dhe 2027/02; nenin 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, nenin 20, paragrafi 2, neneve: 28, dhe 46, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, të Statutit të Komunës; Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale 2027-29 Nr. 02-060/01-0035074/26 dt. 29.06.2026; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 24.09.2026, pasi shqyrtoi Draft-Buxhetin për vitin 2027 dhe vlerësimet për vitet 2028-2029, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa (Konkluzioni Nr. 02-060/01-0053079-2/26 dt. 15.09.2026); sjell këtë:

VENDIM
Për miratimin e Buxhetit të Komunës së Mitrovicës së Jugut për vitin 2027 dhe vlerësimet për vitet 2028-2029

1. MIRATOHET Buxheti i Komunës së Mitrovicës së Jugut për vitin 2027 dhe vlerësimet për vitet 2028-2029.
2. Shuma e Buxhetit për vitin 2027, është 34,045,130.00 €.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është tabela e Planit të Buxhetit për vitin 2027 dhe vlerësimit për vitet 2028-2029.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

REPUBLIKA E KOSOVË KOMUNA E MITROVICËS SË JUGUT MITROVICE-MITROVICA OPŠTINA MITROVICA REPUBLIKA KOSOVO

Kryesuesi i Kuvendit

Safet KAMBERI

Dorëzohet:
1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
1 x 1 MAPL
1 x 1 Arkivit
Kopje: Kryetarit të Komunës
Të gjitha drejtorive

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of South Mitrovica

BUXHETI KOMUNAL

2027 – 2029

Me propozimet e KPF-së

SHTATOR 2026

https://kk.rks-gov.net/mitroviceejugut/

Përmbajtja

..... 1

BUXHETI I KOMUNËS SË MITROVICËS 3

Përmbledhje 3

Procesi i hartimit të Draft-Buxhetit 2027-2029 4

PLANIFIKIMI I TË HYRAVE VETANAKE KOMUNALE PËR VITIN 2027 – 2029 4

Përcaktimi i prioriteteve 6

Identifikimi i kërkesave 7

MISIONI DHE VIZIONI I DREJTORIVE/PROGRAMI 8

PLANIFIKIMI I BUXHETIT SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE PËR VITIN 2027 - 2029 21

PLANIFIKIMI I INVESTIMEVE KAPITALE PËR VITIN 2027 – 2029 29

BUXHETI I KOMUNËS SË MITROVICËS

Buxheti Komunal për vitin 2027 planifikohet në bazë të obligimeve dhe detyrimeve që dalin nga Statuti i Komunës së Mitrovicës dhe është i bazuar në realizimin e buxhetit komunal për vitin 2026, Buxhetit të komunave të Kosovës për vitin 2027 të përcaktuar nga Komisioni i Granteve Qeveritare dhe të miratuar nga Ministria e Financave dhe Kuvendi i Kosovës, në mbështetje të Qarkoreve buxhetore 2027/01 dhe 2027/02 dhe Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Kosovës për vitin 2027-2029, buxhetimit programor si dhe Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2027-2029 për të hyrat dhe shpenzimet, për programet buxhetore sipas kategorive ekonomike dhe atë nga Granti Qeveritar dhe nga të Hyrat Vetanake.

Përmbledhje

Më 29 Qershor 2026, Kuvendi i Komunës së Mitrovicës miratoi Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029, e ndërtuar në përputhje me procedurat e parashikuara buxhetore 2027-2029. Korniza Afatmesme Buxhetore si dokument strategjik ka siguruar ndarjen fillestare të Buxhetit, duke u bazuar në kërkesat e Drejtorive Komunale. Pozitat e lira dhe të paplotësuara në nivel të Komunës së Mitrovicës, për të cilat nuk ka marrëdhënie pune dhe për të cilat nuk ka buxhet për plotësimin e tyre, do të përqendrohen dhe evidentohen në një nënprogram të veçantë, me qëllim të identifikimit dhe trajtimit nga ana e Ministrisë së Financave, në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në Qarkoren Buxhetore 02/2027.

Shenim:
Zyrtarët autorizues për futjen e të dhënave në sistemin BDMS mbajnë të drejtën për plotësim-ndryshim sa i përket kategorisë ekonomike Paga dhe Shtesa duke përfshirë edhe numrin e stafit sipas kërkesave të sistemit BDMS dhe udhëzimeve që do të marrin nga analistët e buxhetit në kuadër të MF-së.

Procesi i hartimit të Draft-Buxhetit 2027-2029

Organizata buxhetore (642) ka zhvilluar procesin e hartimit të Draft-Buxhetit për vitet 2027-2029, në harmoni të plotë me instruksionet e dhëna nga Ministria e Financave, përmes Qarkoreve buxhetore 2027/01 dhe 2027/02, në harmoni me Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029 (KAB), Dëgjimeve Buxhetore me qytetarë dhe me Drejtorët/et Komunal si dhe në zbatim të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, me qëllim që finalizimi i tij të jetë në përputhje me interesat e qytetarëve të komunës sonë, në varshmëri për aq sa edhe kanë lejuar kufinjët e limituar të financimit. Projekt-buxheti përveç burimeve të financimit apo burimeve të fondeve për hartimin e tij, përmban edhe projeksionet e shpenzimeve dhe prioritetet e qeverisë lokale të shpërndara në pesë kategori ekonomike të shpenzimeve. Ministria e Financave ka hartuar Qarkoret buxhetore, bazuar në të dhënat e përcaktuara nga Komisioni i Granteve, i cili ka mandatin e përcaktimit të vlerës së granteve duke zbatuar kriteret e përcaktuara si numri i popullsisë, numri i nxënësve, numrin e pakicave kombëtare etj. Nga këto përcaktime të Komisionit të Granteve ka rezultuar se buxheti i organizatës sonë buxhetore për **vitin 2027** do të ketë shumën prej **34,045,130.00 €**.

Grantet Qeveritare dhe të Hyrat Vetanake Komunale 2027 – 2029				
Nr.	**Përshkrimi**	**2027**	**2028**	**2029**
1	Granti i Përgjithshëm	14,529,076.00	15,186,826.00	16,383,779.00
2	Granti specifik për Arsim	11,682,190.00	12,032,656.00	12,393,636.00
3	Granti specifik për shëndetsi	3,243,374.00	3,340,675.00	3,440,895.00
4	Financimi për Teatro	295,346.00	311,590.00	328,728.00
5	Financimi për Shërbime Rezidencial	230,000.00	200,000.00	200,000.00
6	Financimi i shtëpive për mbrojtjen e	152,500.00	215,000.00	215,000.00
	Gjithësej Granti	**30,132,486.00**	**31,286,747.00**	**32,962,038.00**
7	Të Hyrat Vetanake	3,912,644.00	4,052,266.00	4,282,816.00
	Totali i Buxhetit	**34,045,130.00**	**35,339,013.00**	**37,244,854.00**

Tabela 1

PLANIFIKIMI I TË HYRAVE VETANAKE KOMUNALE PËR VITIN 2027 – 2029

Përshkrimi i Të Hyrave	Parashikimi 2027	Parashikimi 2028	Parashikimi 2029
Çertifiktat e lindjes	7,500.00	7,000.00	7,000.00
Çertifikatat e kurorëzimit	4,000.00	4,000.00	4,000.00
Çertifikatat e vdekjes	4,000.00	4,000.00	4,000.00
Çertifikata tjera	72,000.00	80,000.00	80,000.00
Verifikimi i dokumenteve të ndryshme	11,000.00	10,000.00	10,000.00
Administrata dhe Personeli	**98,500.00**	**105,000.00**	**105,000.00**
Taksat për ushtrim të veprimtarisë	45,000.00	40,000.00	40,000.00
Integrimet Evropiane	**45,000.00**	**40,000.00**	**40,000.00**
Gjobat mandatare nga Inspekcioni	6,000.00	1,000.00	1,000.00
Pranimi teknik i lokalit	10,000.00	2,000.00	2,000.00
Inspeksioni	**16,000.00**	**3,000.00**	**3,000.00**
Tatimi në Pronë	1,089,704.00	1,100,601.00	1,106,104.00
Tatimi ne Tokë	264,665.00	265,988.00	267,318.00
Taksa e regjistrimit të automjeteve	180,000.00	185,000.00	210,000.00
Verifikimi i dokumenteve të ndryshme	1,000.00	1,000.00	1,000.00
Qiraja nga Objektet Publike	5,000.00	5,000.00	5,000.00
Buxhet dhe Financa	**1,540,369.00**	**1,557,589.00**	**1,589,422.00**
Qiraja nga objekti - Therrtorja	7,070.00	7,070.00	7,070.00
Destinimi i tokes	-	-	-
Bujqësia	**7,070.00**	**7,070.00**	**7,070.00**
Leje Mjedisore Komunale	50,000.00	57,000.00	60,000.00
Taksat nga mbeturinat	37,000.00	37,000.00	37,000.00
Pylltaria dhe Inspeksioni	**87,000.00**	**94,000.00**	**97,000.00**
Parkingu publik	30,000.00	35,000.00	37,000.00
Taksa tjera adm. - Meremetimi i varrezave	2,000.00	2,000.00	2,000.00
Zhvillimi Ekonomik	**32,000.00**	**37,000.00**	**39,000.00**
Regjistrimi i trashëgimisë	150,000.00	160,000.00	180,000.00
Verifikimi i dokumenteve të ndryshme	15,000.00	15,000.00	15,000.00
Shfrytëzimi hapsirës publike (Tokë)	145,000.00	150,000.00	155,000.00
Tax per fletposeduese dhe kopje planiapsirës p	20,000.00	40,000.00	40,000.00
Gjeodezi dhe Kadastër	**330,000.00**	**365,000.00**	**390,000.00**
Lejet e ndertimit	1,360,000.00	1,405,707.00	1,519,424.00
Destinimi i tokes	50,000.00	60,000.00	70,000.00
Verifikimi i dokumenteve të ndryshme	-	-	-
Legalizimi i objekteve	42,000.00	50,000.00	70,000.00
Taksa për fletëkërkesa	-	-	-
Reklamat	31,805.00	35,000.00	45,000.00
Shfrytëzimi hapsirës publike	45,000.00	50,000.00	60,000.00
Shitja e pasurisë	4,000.00	4,000.00	4,000.00
Qiraja nga objektet publike	15,000.00	20,000.00	25,000.00

Urbanizmi	**1,547,805.00**	**1,624,707.00**	**1,793,424.00**
Marrja e pëlqimeve për armmbajtje	1,500.00	1,500.00	1,500.00
Vertetim per lirim nga shtetesia	1,000.00	1,000.00	1,000.00
Leje per trashegimi	100.00	100.00	100.00
Vertetim qe merr ndihma sociale	200.00	200.00	200.00
Vertetim mbi ushtrimin e te drejtes prinderore	1,000.00	1,000.00	1,000.00
Mirëqenia Sociale	**3,800.00**	**3,800.00**	**3,800.00**
Qiraja nga objektet publike - sportive	-	-	-
Participimi i bibliotekës	100.00	100.00	100.00
Participimi nga Teatri	2,000.00	2,000.00	2,000.00
Kulturë, Rini dhe Sport	**2,100.00**	**2,100.00**	**2,100.00**
GJITHËSEJ ADMINISTRATA KOMUNALE	**3,709,644.00**	**3,839,266.00**	**4,069,816.00**
Participimi i Shëndetsisë	40,000.00	50,000.00	50,000.00
GJITHSEJ SHËNDETËSIA	**40,000.00**	**50,000.00**	**50,000.00**
Participimi i Çerdhes së Fëmijëve	100,000.00	100,000.00	100,000.00
Participimi i SH.M.T. Arkitekt Sinani	35,000.00	35,000.00	35,000.00
Participimi i SH.M.E. Hasan Prishtina	25,000.00	25,000.00	25,000.00
Participimi i SH.M.M. Xheladin Deda	3,000.00	3,000.00	3,000.00
GJITHSEJ ARSIMI	**163,000.00**	**163,000.00**	**163,000.00**
T O T A L I	**3,912,644.00**	**4,052,266.00**	**4,282,816.00**

Tabela 2

Përcaktimi i prioriteteve

Është e qartë se njëri ndër segmentet më të rëndësishëm në procesin e hartimit të buxhetit është përcaktimi i prioriteteve sidomos në pjesën e investimeve kapitale.

Bazë e përcaktimit të prioriteteve janë kërkesat e qytetarëve të komunës sonë, për të ngritur mirëqenien e tyre. Prioritet kryesor është Arsimi, Shëndetësia dhe Infrastruktura duke mos lënë anash edhe ngritjen e performancës së shërbimeve ndaj qytetarëve përmes Digjitalizimit të shërbimeve.

Shënim:

Përmbushja e kritereve të përcaktuara në Manualin e PIP-it, Udhëzimin Administrativ për Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve Kapitale, si dhe Udhëzimin Administrativ për Kriteret Përzgjedhëse të Projekteve Kapitale, mbetet përgjegjësi e drejtorive komunale propozuese.

Identifikimi i kërkesave

Sipas Orarit për mbajtjen e Dëgjimeve Buxhetore me qytetarë për planifikimin e buxhetit 2027–2029, në kuadër të procesit të hartimit të buxhetit kemi organizuar gjashtë (6) dëgjime buxhetore me qytetarët, me të cilët është komunikuar për identifikimin e nevojave si dhe kërkesave të tyre, gjithashtu përveç këtyre dëgjimeve buxhetore ka pasur edhe takime të rregullta me qytetarë si dhe në përfundim të procesit të hartimit të buxhetit u organizuan takime dhe dëgjime buxhetore edhe me ZKA, Drejtorët e Drejtorive për finalizimin e Draft-Buxhetit 2027-2029 dhe të listës së Projekteve kapitale.

Gjatë këtij procesi të planifikimit të buxhetit për vitin 2027 dhe vlerësimet 2028-2029 duke vepruar sipas Ligjit për Barazi Gjinore Nr.05/L-20, Organizata Buxhetore është përgjegjëse për përfshirjen e buxhetimit të përgjegjëshëm gjinor, me qëllim të garancës për Barazi Gjinore.

MISIONI DHE VIZIONI I DREJTORIVE/PROGRAMI

Zyra e Kryetarit

VIZIONI

Një komunë moderne, transparente dhe e orientuar drejt qytetarit, me qeverisje të përgjegjshme, efikase dhe llogaridhënëse, me zhvillim të qëndrueshëm dhe ofrim të shërbimeve publike cilësore, ku vendimmarrja bazohet në nevojat dhe interesin e qytetarëve.

MISIONI

Kabineti i Kryetarit të Komunës ka për mision të mbështesë Kryetarin në ushtrimin e përgjegjësive të tij ligjore dhe institucionale, si dhe të sigurojë koordinimin dhe funksionimin efikas të punës së ekzekutivit komunal.

Kabineti koordinon dhe përcjell zbatimin e politikave, prioriteteve dhe objektivave të përcaktuara nga Kryetari dhe Komuna, duke siguruar bashkëpunim dhe komunikim të vazhdueshëm ndërmjet drejtorive komunale, institucioneve publike dhe akterëve të tjerë relevantë.

Nëpërmjet koordinimit institucional, komunikimit me qytetarët, transparencës dhe llogaridhënies, Kabineti synon të sigurojë zbatimin e vendimeve dhe prioriteteve të Kryetarit, të lehtësojë adresimin e çështjeve me interes për qytetarët dhe të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve dhe zhvillimit të komunës.

PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR VITIN 2027 - 2029

ZYRA E KRYETARIT

Nr	Kodi ekonomik	Përshkrimi	Planifikimi 2027	Planifikimi 2028	Planifikimi 2029
			TOTALI	TOTALI	TOTALI
	130	MALLRA DHE SHËRBIME	*30,000.00*	*30,000.00*	*30,000.00*
33	13460	SHERBIME KONTRAKTUESE TJERA	*30,000.00*	*30,000.00*	*30,000.00*
		TOTALI	*243,519.00*	*286,365.60*	*286,365.60*

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme

Vizioni

Një administratë komunale moderne, efikase, transparente dhe e orientuar drejt qytetarit, e cila ofron shërbime publike cilësore, të shpejta dhe të qasshme për të gjithë qytetarët.

Misioni

Drejtoria e Administratës ka për mision të sigurojë funksionimin efikas dhe profesional të administratës komunale, duke ofruar shërbime administrative cilësore, transparente dhe të qasshme. Përmes menaxhimit të mirë të burimeve njerëzore, dokumentacionit, proceseve administrative dhe infrastrukturës mbështetëse, drejtoria synon rritjen e efikasitetit institucional dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve ndaj qytetarëve.

PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR VITIN 2027 - 2029

ADMINISTRATA

Nr	Kodi ekonomik	Përshkrimi	Planifikimi 2027	Planifikimi 2028	Planifikimi 2029
			TOTALI	TOTALI	TOTALI
	130	MALLRA DHE SHËRBIME	588,807.00	540,807.00	540,807.00
19	13140	SHPENZIMET E UDHËTIMIT ZYRTAR JASHT VENDIT	1,000.00	1,000.00	1,000.00
20	13141	MEDITJA - UDHËTIMIT ZYRTAR JASHT VENDIT	1,000.00	1,000.00	1,000.00
25	13320	SHPENZIMET E TELEFONISË MOBILE	12,000.00	12,000.00	12,000.00
26	13330	SHPENZIMET POSTARE	1,000.00	1,000.00	1,000.00
29	13420	SHËRBIMET E PËRFAQËSIMIT DHE AVOKATURËS	27,000.00	27,000.00	27,000.00
33	13460	SHERBIME KONTRAKTUESE TJERA	266,667.00	266,667.00	266,667.00
35	13475	SIGURIMI FIZIK I OBJEKTEVE PUBLIKE	168,540.00	120,540.00	120,540.00
39	13503	KOMPJUTERË ME PAK SE 1000 Euro	3,600.00	3,600.00	3,600.00
46	13610	FURNIZIME PËR ZYRË	8,000.00	8,000.00	8,000.00
47	13611	FURNIZIM ME DOKUMENTA BLLANKO	12,000.00	12,000.00	12,000.00
51	13640	FURNIZIME PASTRIMI	15,000.00	15,000.00	15,000.00
60	13720	NAFTE PER NGROHJE QENDRORE	20,000.00	20,000.00	20,000.00
66	13780	KARBURANT PER VETURA	25,000.00	25,000.00	25,000.00
73	13950	REGJISTRIMI I AUTOMJETEVE	6,000.00	6,000.00	6,000.00
74	13951	SIGURIMI I AUTOMJETEVE	6,000.00	6,000.00	6,000.00
78	14010	MIRËMBAJTJA RIPARIMI I AUTOMJETEVE	15,000.00	15,000.00	15,000.00
98	14310	DREKA ZYRTARE	1,000.00	1,000.00	1,000.00
	132	SHPENZIME KOMUNALE	613,400.00	595,000.00	595,000.00
103	13210	RRYMA	413,400.00	395,000.00	395,000.00
104	13220	UJI	120,000.00	120,000.00	120,000.00
105	13230	MBETURINAT	40,000.00	40,000.00	40,000.00
107	13250	SHPENZIMET TELEFONIKE - TELEFONIA FIKSE	40,000.00	40,000.00	40,000.00
	200	SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	132,669.00	132,669.00	132,669.00
113	22202	TRANSFERET PËR PËRFITUES INDIVIDUAL TJERË	132,669.00	132,669.00	132,669.00
	300	SHPENZIME KAPITALE	100,000.00	-	100,000.00
122	31120	NDËRTESAT ADMINISTRATIVE AFARISTE	100,000.00	-	100,000.00
		TOTALI	1,956,010.00	2,284,081.52	2,352,669.12

Drejtoria për Integrime Evropiane

Misioni

Misioni i Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integrime Evropiane është të planifikojë, koordinojë dhe zbatojë politika, programe dhe projekte që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të komunës, rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit privat, krijimin e mundësive të reja për punësim dhe zhvillimin e sipërmarrjes.

Drejtoria synon të krijojë një mjedis të favorshëm për zhvillimin e bizneseve, përmes mbështetjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, promovimit të investimeve, fuqizimit të të rinjve dhe grupeve të tjera të synuara, si dhe përmes bashkëpunimit me institucionet qendrore, donatorët, organizatat ndërkombëtare dhe sektorin privat.

Në fushën e turizmit, Drejtoria angazhohet për zhvillimin dhe promovimin e potencialeve turistike, kulturore dhe natyrore të komunës, krijimin e produkteve të reja turistike dhe rritjen e atraktivitetit të komunës si destinacion turistik.

Në kuadër të integrimeve evropiane, Drejtoria kontribuon në përafrimin e politikave dhe prioriteteve të zhvillimit lokal me standardet dhe praktikat evropiane, në mobilizimin e fondeve dhe programeve të Bashkimit Evropian, si dhe në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar.

Vizioni

Të ndërtojmë një komunë me ekonomi lokale të zhvilluar, konkurruese dhe të qëndrueshme, me një mjedis të favorshëm për bizneset, investimet dhe punësimin, si dhe me një sektor turistik tërheqës dhe të promovuar në nivel lokal, nacional dhe ndërkombëtar.

Drejtoria synon të jetë një institucion modern, efikas dhe bashkëpunues, që nxit sipërmarrjen, inovacionin dhe zhvillimin e sektorit privat, mobilizon investime dhe fonde vendore e ndërkombëtare, promovon potencialet turistike dhe ekonomike të komunës dhe kontribon aktivisht në procesin e integrimit evropian.

PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR VITIN 2027 - 2029

INTEGRIMET EVROPIANE

Nr	Kodi ekonomik	Përshkrimi	Planifikimi 2027	Planifikimi 2028	Planifikimi 2029
			TOTALI	TOTALI	TOTALI
	130	MALLRA DHE SHËRBIME	*20,000.00*	*20,000.00*	*20,000.00*
33	13460	SHERBIME KONTRAKTUESE TJERA	*20,000.00*	*20,000.00*	*20,000.00*
	200	SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	*206,321.00*	*130,305.00*	*130,305.00*
109	21110	SUBVENCIONE PËR ENTITET PUBLIKE	*86,321.00*	-	-
111	21200	SUBVENCIONE PËR ENTIT.JOPUBLIKE	*120,000.00*	*130,305.00*	*130,305.00*
	300	SHPENZIME KAPITALE	*50,000.00*	-	-
132	31240	TROTUARET	*50,000.00*	-	-
		TOTALI	*337,266.00*	*234,094.60*	*234,094.60*

Drejtoria e Inspekcionit

VIZIONI

Vizioni ynë është një Mitrovicë e sigurt, e rregullt dhe me zhvillim të qëndrueshëm, ku respektohet ligji, ruhet hapësira publike dhe zhvillohen veprimtari ndërtimore, ekonomike e shërbyese në përputhje me rregullat dhe standardet e përcaktuara.

Synojmë një drejtori profesionale, efikase dhe të besueshme, e cila ushtron përgjegjësitë e saj me integritet, paanshmëri dhe transparencë. Për ne, trajtimi i barabartë i qytetarëve dhe subjekteve afariste është parim themelor: çdo rast duhet të shqyrtohet mbi bazën e fakteve, kompetencave dhe kërkesave ligjore.

Pjesë e këtij vizioni është krijimi i një kulture të respektimit të ligjit dhe përgjegjësisë së përbashkët, ku qytetarët dhe bizneset i njohin detyrimet e tyre dhe e shohin inspektimin si një shërbim që kontribuon në sigurinë, rregullin dhe mirëqenien e komunitetit.

MISIONI

Misioni i Drejtorisë së Inspekcionit është mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit në fushat e kompetencës së saj, përmes inspektimeve të planifikuara, trajtimit të ankesave dhe reagimit ndaj shkeljeve e rreziqeve të evidentuara. Këtë mision e realizojmë përmes strukturave përgjegjëse për inspektimin e ndërtimit, tregut, transportit rrugor dhe shërbimeve komunale, në bashkëpunim me drejtoritë dhe institucionet përkatëse.

Në ushtrimin e detyrave tona, angazhohemi për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit publik, mjedisit, pronës dhe hapësirave publike, si dhe për respektimin e kushteve ligjore gjatë zhvillimit të veprimtarive që i nënshtrohen mbikëqyrjes sonë. Vëmendje të veçantë synojmë t'u kushtojmë rasteve që paraqesin rrezik për jetën dhe sigurinë e qytetarëve, shkeljeve të përsëritura dhe çështjeve me ndikim të drejtpërdrejtë në komunitet.

Qasja jonë përfshin informimin dhe parandalimin, evidentimin dhe dokumentimin e shkeljeve, ndërmarrjen e masave ligjore dhe përcjelljen e zbatimit të tyre. Masat duhet të jenë të arsyetuara, proporcionale dhe të mbështetura në gjendjen faktike, duke respektuar të drejtat e palëve dhe procedurat përkatëse.

PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR VITIN 2027 - 2029

INSPEKSIONI

Nr	Kodi ekonomik	Përshkrimi	Planifikimi 2027	Planifikimi 2028	Planifikimi 2029
			TOTALI	TOTALI	TOTALI
	130	**MALLRA DHE SHËRBIME**	***110,000.00***	***110,000.00***	***110,000.00***
33	13460	SHERBIME KONTRAKTUESE TJERA	***100,000.00***	***100,000.00***	***100,000.00***
37	**13501**	MOBILJE (ME PAK SE 1000 Euro)	***3,000.00***	***3,000.00***	***3,000.00***
39	13503	KOMPJUTERË ME PAK SE 1000 Euro	***3,000.00***	***3,000.00***	***3,000.00***
46	**13610**	FURNIZIME PËR ZYRË	***3,000.00***	***3,000.00***	***3,000.00***
98	**14310**	DREKA ZYRTARE	***1,000.00***	***1,000.00***	***1,000.00***
TOTALI			***299,360.00***	***333,065.60***	***333,065.60***

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

MISIONI

Misioni i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa është të sigurojë menaxhim të qëndrueshëm, transparent, efikas dhe të përgjegjshëm të burimeve financiare publike të Komunës, përmes planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit, mbikëqyrjes së të hyrave dhe shpenzimeve, si dhe zbatimit të legjislacionit dhe standardeve të menaxhimit të financave publike, me qëllim të mbështetjes së ofrimit të shërbimeve cilësore për qytetarët.

VIZIONI

Një Drejtori profesionale, transparente dhe moderne, që garanton menaxhim të përgjegjshëm dhe efikas të financave publike, planifikim të bazuar në prioritete dhe rezultate, si dhe përdorim optimal të burimeve buxhetore në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të Komunës dhe përmirësimit të mirëqenies së qytetarëve.

PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR VITIN 2027 - 2029

BUXHET DHE FINANCA

Nr	Kodi ekonomik	Përshkrimi	Planifikimi 2027	Planifikimi 2028	Planifikimi 2029
			TOTALI	TOTALI	TOTALI
	130	MALLRA DHE SHËRBIME	*142,000.00*	*770,475.00*	*846,120.00*
28	13410	SHËRBIMET E ARSIMIT DHE TRAJNIMIT	*10,000.00*	*10,000.00*	*10,000.00*
33	13460	SHERBIME KONTRAKTUESE TJERA	*131,000.00*	*759,475.00*	*835,120.00*
98	14310	DREKA ZYRTARE	*1,000.00*	*1,000.00*	*1,000.00*
	300	SHPENZIME KAPITALE	*20,000.00*	*80,000.00*	*4,220,905.00*
122	31120	NDËRTESAT ADMINISTRATIVE AFARISTE	*20,000.00*	*80,000.00*	*4,220,905.00*
		TOTALI	*357,960.00*	*1,086,047.00*	*5,323,597.00*

Drejtoria e Emergjencave

Vizioni

Një komunë e sigurt dhe e përgatitur për përballimin e të gjitha llojeve të emergjencave dhe fatkeqësive, me reagim të shpejtë, profesional dhe të koordinuar për mbrojtjen e jetës, shëndetit, pronës dhe mjedisit.

Misioni

Drejtoria e Emergjencave ka për mision parandalimin, përgatitjen dhe menaxhimin e situatave emergjente dhe fatkeqësive natyrore e të shkaktuara nga faktori njerëzor. Përmes planifikimit, trajnimit, koordinimit dhe reagimit të shpejtë, drejtoria synon të zvogëlojë rrezikun dhe pasojat e emergjencave, duke siguruar mbrojtje dhe ndihmë efektive për qytetarët dhe komunitetin.

PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR VITIN 2027 - 2029

MENAXHIMI I FATKEQËSIVE NATYRORE

Nr	Kodi ekonomik	Përshkrimi	Planifikimi 2027	Planifikimi 2028	Planifikimi 2029
			TOTALI	TOTALI	TOTALI
	130	MALLRA DHE SHËRBIME	210,000.00	210,000.00	210,000.00
19	13140	SHPENZIMET E UDHËTIMIT ZYRTAR JASHT VENDIT	1,500.00	1,500.00	1,500.00
33	13460	SHERBIME KONTRAKTUESE TJERA	201,500.00	201,500.00	201,500.00
34	13470	SHERBIME TEKNIKE	500.00	500.00	500.00
37	13501	MOBILJE (ME PAK SE 1000 Euro)	1,500.00	1,500.00	1,500.00
39	13503	KOMPJUTERË ME PAK SE 1000 Euro	2,000.00	2,000.00	2,000.00
45	13509	PAISJE TJERA <1000	500.00	500.00	500.00
46	13610	FURNIZIME PËR ZYRË	1,000.00	1,000.00	1,000.00
54	13660	AKOMODIMI	500.00	500.00	500.00
98	14310	DREKA ZYRTARE	1,000.00	1,000.00	1,000.00
	300	SHPENZIME KAPITALE	50,000.00	50,000.00	-
145	31690	PAISJE TJERA	50,000.00	50,000.00	-
		TOTALI	308,160.00	305,774.40	258,158.40

Drejtorisa e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

MISIONI

Misioni i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të bujqësisë dhe zonave rurale, duke krijuar kushte dhe mundësi të barabarta për fermerët dhe për subjektet që veprojnë në sektorin rural. Drejtoria synon të ofroj shërbime profesionale,transparente dhe efikase,
të nxisë investime në bujqësi,të përkrah gratë dhe të rinjët në sektorin rural me përfaqesim të barabartë,promovimin e prodhimeve vendore,agropërpunimin ,qasje sa më e lehtë në treg,bujqësi rezistente dhe e qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike,ngritje e kapaciteteve dhe këshillim professional,digjitalizim dhe përmirsim I shërbimeve,ngritje e bashkëpunimit institucional dhe partneritet zhvillimorë I gjithi ky synim I misionit te Drejtorisë arrihet duke e zbatuar hartimin e planit dhe planifikimit buxhetor dhe legjislacionit të programeve mbështetse përmes subvencioneve ,granteve,bashkepunimeve institucionale,organizatave zhvillimore.
Drejtoria e Bujqësi synon ta rrisë produktivitetin, konkurueshmërin dhe qëndrueshmërin e fermerit.

VIZIONI

Vizioni I Drejtorisë së Bujqësisë është që bujqësia të jetë një nga shtyllat e rëndesishme të zhvillimit ekonomik lokal duke krijuar vende pune, rritje të ardhurave familjare në viset rurale, fuqizimin e prodhimit vendore dhe përmiresimin e cilësis së jetesës në komunitet.
Qasje e drejtë, transparente dhe e barabarët në përkrahje, mbështetje të fermereve për zhvillimin e Bujqësisë.

Nr	Kodi ekonomik	Përshkrimi	Planifikimi 2027	Planifikimi 2028	Planifikimi 2029
			TOTALI	TOTALI	TOTALI
	130	MALLRA DHE SHËRBIME	15,000.00	15,000.00	15,000.00
33	13460	SHERBIME KONTRAKTUESE TJERA	14,000.00	14,000.00	14,000.00
98	14310	DREKA ZYRTARE	1,000.00	1,000.00	1,000.00
	200	SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	250,000.00	331,634.00	334,169.00
113	22202	TRANSFERET PËR PËRFITUES INDIVIDUAL TJERË	50,000.00	1,634.00	24,169.00
115	23110	PAGESAT PER SEKTORINË E BLEGTOREISE	30,000.00	100,000.00	100,000.00
116	23130	PAGESAT PER KULTURAT	170,000.00	230,000.00	210,000.00
TOTALI			344,850.00	437,762.00	442,297.00

Drejtoria për Pylltari dhe Inspekcion

Vizioni

Vizioni i Drejtorisë së Mbrojtjes së Mjedisit është, një mjedis i pastër, i shëndetshëm dhe i qëndrueshëm, me hapësira të gjelbra të zhvilluara dhe me menaxhim të përgjegjshëm të burimeve natyrore, për një cilësi më të mirë të jetës së qytetarëve.

Misioni

Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit ka për mision mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit, menaxhimin e qëndrueshëm të hapësirave të gjelbra dhe burimeve natyrore, parandalimin e ndotjes dhe promovimin e një kulture të përgjegjshme mjedisore. Përmes zbatimit të politikave dhe projekteve mjedisore, monitorimit të gjendjes së ambientit dhe bashkëpunimit me qytetarët dhe institucionet relevante, synohet krijimi i një mjedisi të sigurt dhe të qëndrueshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR VITIN 2027 - 2029

PYLLTARI DHE INSPEKSION

Nr	Kodi ekonomik	Përshkrimi	Planifikimi 2027	Planifikimi 2028	Planifikimi 2029
			TOTALI	TOTALI	TOTALI
	130	MALLRA DHE SHËRBIME	5,000.00	5,000.00	5,000.00
33	13460	SHERBIME KONTRAKTUESE TJERA	4,000.00	4,000.00	4,000.00
98	14310	DREKA ZYRTARE	1,000.00	1,000.00	1,000.00
TOTALI			63,150.00	73,781.60	73,781.60

Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik

MISIONI

Misioni i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës është të sigurojë ofrimin e shërbimeve publike cilësore, të qëndrueshme dhe profesionale, si dhe planifikimin, zhvillimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës komunale, në funksion të rritjes së cilësisë së jetës së qytetarëve.

DSHPI synon të realizojë përgjegjësitë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet profesionale dhe teknike, duke siguruar përdorim efikas dhe transparent të burimeve publike, planifikim të qëndrueshëm dhe bashkëpunim me institucionet, komunitetin dhe ofruesit e shërbimeve.

Misioni përfshin veçanërisht:

- zhvillimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore dhe hapësirave publike;
- përmirësimin e shërbimeve të ujësjellësit, kanalizimit, ndriçimit publik, mirëmbajtjes së rrugëve dhe shërbimeve të tjera komunale;
- zhvillimin e transportit, trafikut dhe sinjalizimit rrugor;
- menaxhimin dhe monitorimin profesional të projekteve infrastrukturore;
- sigurimin e shërbimeve të barabarta, transparente dhe të orientuara drejt nevojave të qytetarëve.

VIZIONI

Vizioni i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës është krijimi i një Komune me **infrastrukturë moderne, të sigurt, funksionale dhe të qëndrueshme**, si dhe me **shërbime publike cilësore, efikase dhe të qasshme për të gjithë qytetarët**.

DSHPI synon të jetë një drejtori profesionale, transparente dhe e orientuar drejt rezultateve, e cila përmes planifikimit të mirë, përdorimit efikas të burimeve, ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe aplikimit të standardeve bashkëkohore kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm të Komunës së Mitrovicës dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mirëqenies së qytetarëve.

PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR VITIN 2027 - 2029

ZHVILLIM EKONOMIK

Nr	Kodi ekonomik	Përshkrimi	Planifikimi 2027	Planifikimi 2028	Planifikimi 2029
			TOTALI	TOTALI	TOTALI
	130	MALLRA DHE SHËRBIME	*1,750,000.00*	*1,750,000.00*	*1,750,000.00*
19	13140	SHPENZIMET E UDHËTIMIT ZYRTAR JASHT VENDIT	*2,000.00*	*2,000.00*	*2,000.00*
33	13460	SHERBIME KONTRAKTUESE TJERA	*675,000.00*	*675,000.00*	*675,000.00*
37	**13501**	MOBILJE (ME PAK SE 1000 Euro)	*2,000.00*	*2,000.00*	*2,000.00*
39	13503	KOMPJUTERË ME PAK SE 1000 Euro	*5,000.00*	*5,000.00*	*5,000.00*
46	**13610**	FURNIZIME PËR ZYRË	*1,000.00*	*1,000.00*	*1,000.00*
86	14032	MIRËMBAJTJA AUTO RRUGE.LOKALE	*270,000.00*	*270,000.00*	*270,000.00*
89	14060	MIRËMBAJTJA RUTINORE	*794,000.00*	*794,000.00*	*794,000.00*
98	**14310**	DREKA ZYRTARE	*1,000.00*	*1,000.00*	*1,000.00*

	300	SHPENZIME KAPITALE	6,030,979.00	7,109,372.00	5,205,000.00
131	31230	NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE	5,255,979.00	6,230,000.00	4,505,000.00
133	31250	KANALIZIMI	200,000.00	250,000.00	400,000.00
134	31260	UJËSJELLËSI	175,000.00	229,372.00	300,000.00
136	31510	FURNIZIM ME RRYMË, GJENRIMI TRANSMISION	200,000.00	400,000.00	-
145	31690	PAISJE TJERA	200,000.00	-	-
		TOTALI	7,851,769.00	8,959,530.40	7,060,158.40

Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër

Misioni

Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër angazhohet për zbatimin e legjislacionit në fuqi, mbrojtjen dhe garantimin e sigurisë juridike të prones, përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve dhe zhvillimin e një sistemi modern dhe të digjitalizuar të administrimit të të dhënave pronësore.

Misioni i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër është të sigurojë administrimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e saktë, të sigurtë dhe transparent të të dhënave kadastrale.

Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër është e fokusuar në ofrimin e shërbimeve profesionale, efikase dhe të barabarta për qytetarët, bizneset dhe Institucionet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Vizioni

Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër synon të kontribuojë në sigurinë juridike të pronës, planifikimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të territorit dhe në rritjen e besimit të qytetarëve në shërbimet komunale.

Vizioni i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër është të jetë një institucion modern, profesional, transparent dhe i digjitalizuar, që garanton të dhëna të sakta dhe të përditësuara për pronat, ofron shërbime të shpejta cilësore dhe kontribuon në sigurinë juridike të pronës dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komunës.

PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR VITIN 2027 - 2029

GJEODEZI DHE KADASTËR

Nr	Kodi ekonomik	Përshkrimi	Planifikimi 2027	Planifikimi 2028	Planifikimi 2029
			TOTALI	TOTALI	TOTALI
	130	MALLRA DHE SHËRBIME	10,000.00	10,000.00	10,000.00
33	13460	SHERBIME KONTRAKTUESE TJERA	7,000.00	7,000.00	7,000.00
46	13610	FURNIZIME PËR ZYRË	2,000.00	2,000.00	2,000.00
98	14310	DREKA ZYRTARE	1,000.00	1,000.00	1,000.00
	300	SHPENZIME KAPITALE	6,000.00	-	-
145	31690	PAISJE TJERA	6,000.00	-	-
		TOTALI	117,240.00	148,250.40	148,250.40

DREJTORISË PËR PLANIFIKIM DHE URBANIZËM

MISIONI

Bazohet në parimet e Zhvillimit të qëndrueshëm, digjitalizimit të shërbimeve dhe Integrimin Mjedisor. Misioni i Drejtorisë është: Rregullimi, Planifikimi dhe menaxhimi racional i territorit të Komunës, nëpermjet hartimit dhe zbatimit të dokumenteve rregulluese të Planifikimit Urban dhe Rural. Drejtoria synon të sigurojë një zhvillim të balancuar, të mbrojë burimet natyrore dhe të ofrojë shërbime transparente e të shpejta për qytetarët dhe bizneset, duke garantuar zbatimin e ligjshmërisë në ndërtim dhe urbanizëm.

VIZIONI

Vizioni për vitin 2026 synon shndërrimin e zonave urbane dhe rurale në hapësira moderne, të jetueshme, të sigurta dhe të qëndrueshme. Fokusi kryesor është krijimi i qyteteve "të zgjuara", përmes digjitalizimit të lejeve të ndërtimit, zhvillimit të infrastruktures së gjelbër dhe përshtatjes me ndryshimet klimatike.

PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR VITIN 2027 - 2029

PLANIFIKIMI HAPSINOR DHE RREGULLATIV

Nr	Kodi ekonomik	Përshkrimi	Planifikimi 2027	Planifikimi 2028	Planifikimi 2029
			TOTALI	TOTALI	TOTALI
	130	MALLRA DHE SHËRBIME	*10,000.00*	*10,000.00*	*10,000.00*
33	13460	SHERBIME KONTRAKTUESE TJERA	*9,000.00*	*9,000.00*	*9,000.00*
98	14310	DREKA ZYRTARE	*1,000.00*	*1,000.00*	*1,000.00*
	300	SHPENZIME KAPITALE	*80,000.00*	*120,000.00*	*100,000.00*
121	31110	NDËRTESAT E BANIMIT	*80,000.00*	*120,000.00*	*100,000.00*
TOTALI			*220,875.00*	*286,605.60*	*271,605.60*

Drejtoria e Shëndetësisë

MISIONI

Misioni i Drejtorisë së Shëndetësisë është të planifikojë, koordinojë dhe zhvillojë shërbimet shëndetësore komunale, duke garantuar qasje të barabartë, cilësi dhe siguri në ofrimin e kujdesit shëndetësor, me fokus në parandalim, promovim të shëndetit dhe përmirësim të vazhdueshëm të shërbimeve për qytetarët.

VIZIONI

Vizioni i Drejtorisë së Shëndetësisë është të sigurojë shërbime shëndetësore cilësore, të qasshme dhe të barabarta për të gjithë qytetarët, përmes forcimit të kujdesit parësor shëndetësor, përmirësimit të infrastrukturës dhe pajisjeve, zhvillimit të vazhdueshëm profesional të stafit dhe orientimit të shërbimeve drejt nevojave të qytetarëve.

ADMINISTRATA E SHËNDETËSISË

Nr	Kodi ekonomik	Përshkrimi	Planifikimi 2027	Planifikimi 2028	Planifikimi 2029
			TOTALI	TOTALI	TOTALI
	130	MALLRA DHE SHËRBIME	41,000.00	41,000.00	41,000.00
33	13460	SHERBIME KONTRAKTUESE TJERA	40,440.00	40,440.00	40,440.00
98	14310	DREKA ZYRTARE	560.00	560.00	560.00
	200	SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	80,000.00	130,000.00	130,000.00
113	22202	TRANSFERET PËR PËRFITUES INDIVIDUAL TJERË	80,000.00	130,000.00	130,000.00
	300	SHPENZIME KAPITALE	410,000.00	400,000.00	-
124	31122	OBJEKTET SHËNDETËSORE	50,000.00	-	-
136	31510	FURNIZIM ME RRYMË, GJENRIMI TRANSMISION	60,000.00	-	-
142	31660	PAISJE SPECIALE MJEKSORE	300,000.00	400,000.00	-
		TOTALI	571,280.00	617,529.60	217,529.60

Drejtoria për Shërbime Sociale

VIZIONI

Të ndërtojmë një arkitekturë të plotë sociale dhe një komunë gjithëpërfshirëse, me shërbime sociale cilësore, mundësi të barabarta dhe mbështetje të qëndrueshme për çdo qytetar, me prioritet fëmijët me aftësi të kufizuara, familjet dhe të gjitha kategoritë në nevojë.

MISIONI

Të ofrojmë shërbime sociale të qasshme, cilësore dhe në kohë, të mbrojmë dhe fuqizojmë kategoritë në nevojë dhe të krijojmë mundësi për punësim/vetëpunësim dhe pavarësi ekonomike.
Përmes bashkëpunimit të ngushtë me institucionet publike, ofruesit e shërbimeve sociale, organizatat e shoqërisë civile, shoqatat, sektorin privat dhe donatorët, Drejtoria zhvillon programe dhe partneritete që forcojnë sistemin social dhe rrisin mirëqenien e qytetarëve.
Qëllimi ynë është një sistem social që nuk ofron vetëm mbështetje, por krijon mundësi, fuqizon individin dhe familjen duke ndërtuar pavarësi.

PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR VITIN 2027 - 2029

MIRËQENIA SOCIALE

Nr	Kodi ekonomik	Përshkrimi	Planifikimi 2027	Planifikimi 2028	Planifikimi 2029
			TOTALI	TOTALI	TOTALI
	130	MALLRA DHE SHËRBIME	20,000.00	20,000.00	20,000.00
33	13460	SHERBIME KONTRAKTUESE TJERA	19,000.00	19,000.00	19,000.00
98	14310	DREKA ZYRTARE	1,000.00	1,000.00	1,000.00
	200	SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	278,984.00	323,366.00	320,831.00
111	21200	SUBVENCIONE PËR ENTIT.JOPUBLIKE	10,000.00	-	-
112	22200	TRANSFERET SOCIALE PËR INDIVIDË	30,000.00	79,542.00	79,542.00
114	22298	PAGESA PER SHERBIMET E VARRIMIT	238,984.00	243,824.00	241,289.00
		TOTALI	494,814.00	580,744.00	583,209.00

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Vizioni

Një komunitet aktiv, kreativ dhe gjithëpërfshirës, ku kultura, rinia dhe sporti zhvillohen si shtylla të rëndësishme të jetës shoqërore, duke krijuar mundësi të barabarta për pjesëmarrje, zhvillim dhe promovim të talenteve.

Misioni

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka për mision të krijojë kushte dhe mundësi për zhvillimin e jetës kulturore, fuqizimin dhe përfshirjen e të rinjve dhe zhvillimin e sportit. Përmes mbështetjes së aktiviteteve kulturore, programeve rinore, klubeve dhe organizatave sportive, ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore dhe krijimit të hapësirave të përshtatshme për aktivitete, drejtoria synon të kontribuojë në zhvillimin social, kulturor dhe fizik të komunitetit.

PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR VITIN 2027 - 2029

KULTURË, RINI DHE SPORT

Nr	Kodi ekonomik	Përshkrimi	Planifikimi 2027	Planifikimi 2028	Planifikimi 2029
			TOTALI	TOTALI	TOTALI
